



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 145, datë 08.04.2021

**PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES MARGARITA
BUHALI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT VITI 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Margarita Buhali, për periudhën e vlerësimit viti 2019”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Margarita Buhali, për periudhën e vlerësimit viti 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

EKSTRAKT

RAPORT
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARES
MARGARITA BUHALI
VITI 2019

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1. A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi pa qenë e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit e shqyrton çështjen në bazë të juridiksionit fillestar që ajo ka¹.

¹Vendimi nr.272, datë 05.12.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në 8 vendimet e analizuara, një prej të cilëve mendim pakice, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale në fazën e ekzekutimit*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale, gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi apo si juridiksion fillestar në çështjet civile*), faktet parashtrohen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit. Edhe pse në dokumentat ligjorë nuk rezultojnë një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe duke i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Në rastet kur shkaqet e ankimit nuk i referohen përcaktimit të gabuar të rrethanave të faktit, për përcaktimin e këtij të fundit, gjyqtarja nuk ripërsërit dhe as liston provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Ajo i përmbahet dhe evidenton faktet e provuara në gjykimin në shkallë të parë.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), në mënyrë të pavarur nga çka kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre dhe këtë e bën si pjesë të një procesi vlerësimi të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Kjo vëmendje për të pasqyruar saktë rrethanat e çështjes, me qëllim nxjerrjen më pas të faktit juridik civil apo penal dhe kualifikimin e tij ligjor, konstatohet edhe në ato dokumente ligjore në të cilat gjyqtarja ka vlerësuar ndryshe nga mendimi i shumicës, duke mos u mjaftuar vetëm me pasqyrimin e mendimit për zgjidhjen e çështjes, por duke bërë njëkohësisht pasqyrimin dhe cilësimin ndryshe të faktit juridik². Faktet e çështjes nuk pasqyrohen vetëm në ato raste kur, gjatë gjykimit në shkallë të dytë, pala ankuese ushtron të drejtën e tij për të hequr dorë nga ankimi me pasojë mospranimi, duke qenë se gjykata e apelit shqyrton çështjen në shkallë të dytë vetëm mbi bazë ankimi të palëve³.

Në çdo dokument ligjor (vendim gjyqësor apo mendim pakice) evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon, për cilësim të saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi.

-Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja konkludon në vendim për natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative apo penale, si dhe institutin përkatës juridik (*shpërblim dëmi, parashkrim fitues, fitim i munguar ...etj*). Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës dhe përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467 pg 1 gërma “a” e K.Pr.Civile⁴. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe në rastet kur përcaktimi i

²Vendimi nr.272, datë vendimi 05.12.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë, në të cilën konstatohet se gjyqtarja ka vlerësuar ndryshe nga shumica dhe duke dhënë mendimin e saj të arsyetuar.

³ Vendimi nr. 102 , datë vendimi 13.03.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁴ Vendimi nr. 576 datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

natyrës së çështjes nuk bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ajo kuptohet qartësisht nga analiza e secilit element të kërkuar nga ligji.

- **Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm**

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e pretendimeve për shkelje procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (mosmarrëveshje pronësie, pune apo shpërblim dëmi), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve të posaçme. Në vendimin nr. 576 datë 26.09.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë (me objekt shpërblim dëmi), gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale (nenet 476, 480, 486 të K.Civil) mbi pasojën e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore ndërmjet palëve ndërgjyqëse si dhe dispozitat materiale (nenet 640, 625 dhe neni 647/a të K.Civil) në lidhje me shpërblimin e dëmit jopasuror (dëmi moral). Në vendimin gjyqësor përcaktohet se zgjidhja e mosmarrëveshjes të referon tek ligjet e posaçme ku gjen rregullim kjo marrëdhënie juridike dhe për këtë qëllim citon dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm (ligji i kohës) nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore, udhëzimet e nxjerra për zbatim të tij, si dhe nenin 142 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me fuqinë e akteve nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të tij. Po kështu në vendimin nr. 646 datë vendimi 23.10.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë (me objekt dëmshpërblim që rrjedh nga marrëdhënia e punës), gjyqtarja i referohet jo vetëm dispozitave materiale të K.Punës (nenet 145 dhe 148 të K.Punës) por edhe VKM nr. 106/2012, si dhe aktet nënligjore, udhëzimet e nxjerra për zbatim të tij. Në vendimin nr. 272, datë vendimi 05.12.2019 e Gjykatës së Apelit Vlorë, gjyqtarja në mendimin e saj të arsyetuar (në pakicë), ka identifikuar ligjin e posaçëm të zbatueshëm nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës” (nenet 26 dhe 28 të ligjit) dhe ligjin e kohës në momentin e paraqitjes së kërkesës për njohjen e pronësisë pranë ATP-së (ligjin nr. 9235/2004 dhe VKM 255/2010) në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile lidhur me :

- a) juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, vetëm në rastet kur kjo çështje është bërë objekt i ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor në apel;⁵
- b) ndryshimin e objektit të padisë në rastet kur pretendimi se është ndryshuar objekti dhe shkaku ligjor njëkohësisht është bërë objekt ankimi në apel,⁶etj

⁵Vendimi nr. 576 datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁶Vendimi nr. 646 datë 23.10.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në çdo vendim gjyqësor, evidentohet norma procedurale (*neni 459 dhe 465 i K.Pr.Civile*) në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Apel, duke treguar kujdesin e duhur që shqyrtimi i çështjes t'i referohet vetëm shkaqeve të pretenduara në ankim nga palët.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal, por edhe në ligjet e posaçme në rastet kur dispozita penale është një dispozitë “blankete” e cila të referon tek ligji organik, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit. Konkretisht në vendimin nr. 79 datë vendimi 05.03.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, gjyqtarja identifikon nenin 204 i K.Penal si dhe ligjin e posaçëm (*ligji nr. 64/2012 datë 31.05.2012 dhe rregullorja nr. 1 datë 07.03.2014, neni 4 pika 16 dhe 17 e kësaj rregulloreje*) tek të cilat të referon dispozita penale, gjatë analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të veprës penale së peshkimit të paligjshëm. Në vendimin nr. 425, datë vendimi 04.12.2019, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale për kualifikimin ligjor të faktit penal (*nenin 257/a/1 të K.Penal*) si dhe ligjin e posaçëm që ka lidhje me faktin penal (*ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 i ndryshuar*). Në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47,48, 49 dhe 59 të K.Penal*), apo në lidhje me tentativën (*neni 22 dhe 23 i K.Penal*) si dhe dispozitën ligjore në lidhje me institutin e lirimit me kusht (*neni 64 i K.Penal*), duke qenë se kjo dispozitë e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal është edhe ligji i zbatueshëm drejtpërsëdrejti në zgjidhjen e çështjes⁷.

Citimi i dispozitës procedurale penale (*neni 425 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Apel, cilësohet jo vetëm si kusht procedural në fillimin të analizës së shkaqeve të ankimit, por shoqëron argumentimin e gjykatës edhe në rast të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, kur ankimi vjen prej tij në lidhje me masën e dënimit.⁸

-Konflikti i normave material apo procedurale

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

⁷ Vendimi nr. 244 datë 23.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁸ Vendimi nr.425, datë vendimi 04.12.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe vendimi nr. 79 datë vendimi 05.03.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në 8 vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, rast citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*) dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit. Gjithashtu konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin sistematik të tyre (*nenet 168, 170 të K.Civil*), apo në këndvështrimin historik (*ndryshimet e ligjeve*) dhe krahasues të tyre,⁹ gjithmonë në funksion të përcaktimit të qëllimit të ligjit të zbatueshëm.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës. Interpretimi i normës lidhet gjithmonë me faktet e provuara. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se:

- a) Për të përcaktuar vlerën e dëmshpërblimit të dëmit jopasuror (*dëmit moral*) gjyqtarja duke ia përputhur çdo fakt dhe provë të lejuar dhe marrë në shqyrtim, analizës doktrinale në lidhje me dëmin jopasuror dhe duke u bazuar edhe në parime të së drejtës, konkludon për masën e dëmshpërblimit moral, pa e vendosur atë apriori, por duke vlerësuar kritere të mirëpërcaktuara¹⁰;

⁹ Vendimi nr.272, datë 05.12.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë. Këtë interpretim gjyqtarja e bën nën vështrimin krahasues të ligjit aktual të zbatueshëm (*ligjit nr. 133/2015 dhe VKM 222/2016*) dhe atij të kohës në momentin e paraqitjes së kërkesës për njohje pronësie të subjektit (*ligjit nr. 9235/2004 dhe VKM 255/2010*) për të konkluduar se qëllimi i ligjeve të sipërcituara ka qenë trajtimi në mënyrë të barabartë të subjekteve të shpronësuar.

¹⁰ Vendimi nr. 576, datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

- b) Në lidhje me fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, gjyqtarja interpreton dispozitën materiale (*nenin 186 të K.Civil*) si ligj i zbatueshëm, ku fillimisht pasi ndalet në interpretimin teorik të saj, më pas ndalet në mënyrë të veçantë tek plotësimi i çdo kushti në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat e administruara.¹¹
- c) Në rastin e lirimit para kohe me kusht gjyqtarja interpreton nenin 64 të K.Penal, jo vetëm në aspektin teorik të tij duke përcaktuar kushtet që duhet të plotësojë i dënuari në mënyrë kumulative me qëllim që të përfitojë lirimin me kusht, por edhe mbi gjendjen e fakteve të provuara.¹²

Përpos dispozitave të Kodit Civil dhe atij Penal, gjykata interpreton edhe ligjet e posaçme relevante të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile apo asaj penale¹³, të evidentuara në raportin analitik për çdo vendim gjyqësor.

- Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale

Gjykata referuar pretendimeve të ngritura nga ana e palëve në ankim (*të paditurit*), interpreton në përputhje me rrethanat e faktit, dispozitat procedurale që kanë lidhje me përcaktimin e kompetencës lëndore të shqyrtimit të çështjes (*nenin 61 të K.Pr.Civile dhe në mënyrë të veçantë nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 për gjykatat administrative*), për të konkluduar referuar këtij interpretimi se çështja objekt gjykimi është në kompetencë lëndore të kësaj gjykate përsa kohë jemi para një marrëdhënie juridike civile (*marrëdhënie kontraktore me palë private dhe jo organe administrative*)¹⁴. Në një rast tjetër,¹⁵ interpreton dispozitat procedurale penale (*nenin 418 dhe 420 të K.Pr.Penale*) në lidhje me efektet që ka heqja dorë e palës ankuese/prokurorit nga ankimi, duke përcaktuar se është e drejtë e organit të akuzës që deri para fillimit të diskutimit përfundimtar të çështjes në apel, të heqë dorë nga ankimi.

Gjyqtarja i kushton rëndësi gjatë zbatimit të normave juridike, edhe hierarkisë së tyre.¹⁶

- Në lidhje me aftësinë e gjyqarrit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- aplikimin e procedimit me gjykim të shkurtuar ku përmend vendimin unifikues nr. 2, datë 29.1.2013;
- ekzistencën e figurës autonome të dëmit jopasuror, atë të dëmit moral të shkaktuar paditësit nga veprimet apo mosveprimet e palës së paditur, në të cilën gjykata ndalet në përcaktimet dhe konkluzionet e unifikuara sipas vendimit unifikues nr. 12/2007;
- “arsyet e veçanta” sipas nenit 64 të K.Penal ku përmend vendimin unifikues nr. 2 datë 25.05.2015...etj

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

¹¹ Vendimi nr. 745 datë 20.11.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹² Vendimi nr. 244 datë 23.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹³ Vendimi nr. 646, datë 23.10.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

¹⁴ Vendimi nr. 576, datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

¹⁵ Vendimi nr. 102, datë 13.03.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

¹⁶ Vendimi nr. 646, datë 23.10.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Në mënyrë më specifike, në vendimin nr. 425, datë vendimi 04.12.2019, gjatë arsytimit dhe analizës juridike, zbaton parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi duke qenë se e shqyrton çështjen mbi bazë ankimi vetëm nga i pandehuri, nuk mund ta rëndojë pozitën e tij. Ky parim zbatohet gjithashtu edhe gjatë analizës juridike të individualizimit të dënimit për të pandehurin. Ndërkohë në çështjet civile duke iu referuar nenit 459 dhe 465 të K.Pr.Civile sipas së cilës gjykata e apelit e shqyrton çështjen mbi bazë ankimi dhe vetëm përse është parashtruar në ankim, tregon kujdes të mosçënojë disponime të shkallës së parë, për të cilat nuk është bërë ankim, pavarësisht të një qasjeje ndryshe në lidhje me një fakt apo rrethanë të caktuar që do të mund të çonte në një konkluzion tjetër të arritur nga vendimi i shkallës së parë.¹⁷Gjithashtu konstatohet zbatimi i parimit të proporcionalitetit gjatë arsytimit dhe konkluzionit të arritur në lidhje me masën e dëmshpërblimit të dëmit moral,¹⁸ parimi i procesit të rregullt ligjor dhe parimi i barazisë së shtetasve para ligjit në lidhje me trajtimin në mënyrë të barabartë të subjekteve të shpronësuar.¹⁹Identifikohet dhe reflektohet përmbushja e parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor apo parimi i disponibilitetit të palëve në lidhje me të drejtën për të hequr dorë nga ankimi me pasojë mospranimin e tij,²⁰ etj.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

¹⁷Vendimi nr. 576, datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹⁸Po aty

¹⁹ Vendimi nr. 272, datë 05.12.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

²⁰Vendimi nr. 102, datë 13.03.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

Vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Gjyqtarja, përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që çenojnë integritetin e personit, apo përdorimi i fjalëve fyese apo denigruese. Gjyqtarja përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (jo gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine²¹, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezulton të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf në paragrafin tjetër dhe në disa raste, edhe duke e numërtuar.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gabimet gramatikore janë të papërfillshme dhe në atë masë që nuk ndikojnë në shkallën e aftësisë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së

²¹ Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën apo cilësinë e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër. Pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Çështje, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) apo CRAC (*Konkluzion, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet, si jo vetëm prezantimit të fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në proces.

Pjesa përshkuese – arsyetuese është e ndarë në disa nën pjesë. Edhe pse jo me tituj të përcaktuar si p.sh : rrethanat e faktit; ligji i zbatueshëm; apo analiza juridike, nga mënyra e se si ato pasqyrohen në vendim, konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nëndarje. Në pjesën përshkuese analizohen në mënyrë të detajuar: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, rrethanat procedurale në gjykimin në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, si dhe data e shpalljes së vendimit.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Vendimet janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsytimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, dhe në disa raste zbaton rregullat e shkrimit ligjor sipas metodës IRAC²², në rastet e tjera gjyqtari identifikon faktet,

²² Në vendimin nr. 646, datë 23.10.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor. Gjyqtarja përdor një metodë të caktuar në strukturimin e vendimit edhe pse në aspektin vizual jo gjithmonë është e dallueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar²³.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha dokumentet ligjorë të analizuar, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithmonë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale (*si çështja e kompetencës lëndore²⁴ apo e ekzistencës apo jo të një padie të re me ndryshimin e objektit të padisë²⁵*). Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtares në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i

²³ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

²⁴ Vendimi nr. 576, datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

²⁵ Vendimi nr. 646, datë 23.10.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë

dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse/shkaqeve të ankimit.

Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme psh:

- (i) Institutit të parashkrimit fitues si një mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë²⁶;
- (ii) Institutit juridik të shpërblimit për vjetërsi në punë duke vijuar analizën edhe në lidhje me dallimin e tij nga konceptet e tjera të dëmshpërblimit që rrjedh nga marrëdhëniet e punës²⁷;
- (iii) Institutit juridiko-civil të dëmit jashtëkontraktor, dhe në mënyrë të veçantë të figurës autonome të dëmit jopasuror duke analizuar shkaqet se përse duhet pranuar dëmi jopasuror (*moral*), analizë të cilën gjykata e mbështet jo vetëm duke iu referuar fakteve dhe duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e unifikuar të gjykatës së lartë, por duke i bërë edhe një trajtim doktrinal kësaj figure dëmi në lidhje me përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar, pa e vendosur atë apriori, por bazuar në kritere të përcaktuara²⁸;
- (iv) Institutit të lirimit me kusht si mjet i jashtëzakonshëm i ndërprerjes së mëtejshme të dënimit, vetëm në rastet e parashikuara në ligj, e në vijim duke i analizuar në mënyrë të detajuar këto kritere në përputhje edhe me konkluzionet e arritura nga Gjykata e Lartë.²⁹

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur nga ana e gjyqtarës për arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, i kushtohet rëndësi e veçantë, marrëdhënies shkak – pasojë, si në marrëdhëniet juridike civile ashtu dhe në çështjet penale.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin : fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse që përbëjnë shkaqe ankimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

²⁶Vendimi nr.745, datë 20.11.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë

²⁷Vendimi nr. 646, datë 23.10.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

²⁸Vendimi nr.576, datë 26.09.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

²⁹Vendimi nr. 244, datë 23.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.Penale. Referuar raportit analitik nga 40 (dyzet) çështjet e gjykuara për të cilat ligji ka parashikuar afat gjykimi, ky i fundit është tejkaluar si më poshtë në :

(i) 2 (dy) çështje tek kategoria e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (60 ditë) të parashikuar në nenin 609 të K.Pr.Civile. Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelat statistikore dhe raportit analitik, rezulton se të dy çështjet janë regjistruar në Gjykatën e Apelit Vlorë në Janar 2017 dhe Korrik 2017. Afati ligjor 60 ditë për përfundimin e tyre është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016, ligj ky i cili është miratuar në datë 03.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi në datë 30.11.2016, pra 15 ditë pasi është botuar në fletoren zyrtare nr. 219 datë 15.11.2016. Në lidhje me këto dy çështje vlerësoj se pavarësisht faktit se në kohën e regjistrimit të tyre në Gjykatën e Apelit (Janar 2017 dhe Korrik 2017), ky ligj kishte hyrë në fuqi dhe pavarësisht rregullit të ligjit procedural në kohën e gjykimit, afati 60 ditë për përfundimin e tyre nuk duhet të llogaritet si afat për gjykimin e çështjes në Apel, por duhet të konsiderohen si dy çështje me afat standard minimal kohor, pasi ligji i ri nr. 114/2016 që ka sjellë këtë ndryshim nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesë padive përkatëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, e për pasojë nuk duhet të jetë as ligji procedural në gjykimin në Apel. Ky interpretim është edhe nën frymën e legjislatorit të parashikuar në nenin 109 të ligjit 38/2017, pavarësisht faktit që vetë ligji nr. 114/2016 nuk parashikonte ndonjë dispozitë kalimtare në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.

(ii) 1 (një) çështje tek kategoria e çështjeve “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, e cila ka përfunduar tej afatit ligjor dhe më konkretisht çështja me nr. 18 rendor e cila ka përfunduar jashtë afati ligjor (60 ditë) nga data e regjistrimit të çështjes.

(iii) 1 (një) çështje tek tabela nr. 3 tek kategoria e çështjeve “*familjare me palë kundërshtare*” me objekt urdhër mbrojtje e cila ka përfunduar jashtë afatit ligjor prej 15 ditësh nga momenti i regjistrimit të çështjes (ankimit) sipas nenit 21/2 i ligjit nr. 47/2018, këto çështje duhet të përfundojnë brenda një afati prej 15 ditësh nga momenti i regjistrimit të çështjes (ankimit).

(iv) 2 (dy) çështje tek tabela nr.10 tek kategoria “*kërkesa në fazën e hetimeve paraprake*” dhe më konkretisht çështjet me nr. 19 dhe 23 të cilat kanë përfunduar tej afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 291/5 të K.Pr.Penale.

Sa më sipër, duke hequr 2 (dy) çështjet tek kategoria e çështjeve “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara (38 çështje), për të cilat ligji parashikon afat ligjor, është 4 (katër)³⁰, duke rezultuar se gjyqtarja ka gjykuar 10.5 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

KONKLUZIONE:

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Referuar ngarkesës së gjyqtarës si relatore dhe anëtare (në total ka gjykuar 403 çështje si relator dhe 205 çështje si anëtar), angazhimin e saj si anëtare e KED-së në këtë periudhë vlerësimi, mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarit, tejkalimi me vetëm 0,5 % i përqindjes së lejuar për vlerësim maksimal është i papërfillshëm për të ndikuar tek ky i fundit dhe në një llogaritje matematikore 10,5 % ~10 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është brenda marzhit “0-10 %”.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet përgjithësisht kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

(i) 3 (tre) çështje tek tabela nr. 1 e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, dhe më konkretisht çështja me nr. 1, nr. 15 dhe nr. 31 rendor, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së, dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

³⁰ Duke zbritur 2 çështjet tek tabela nr. 1 nga çështjet me afat ligjor si me sipër arsyetuar.

(ii) 2 (dy) çështje tek tabela nr. nr. 7, tek kategoria e çështjeve “*marrëdhënie pune*”, me nr. 1 dhe 17 rendor kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(iii) 2 (dy) çështje tek tabela nr. 8, tek kategoria e çështjeve “*penale krime*”, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(iv) 2 (dy) çështje tek tabela nr. 9 tek kategoria e çështjeve “*penale kundërvajtje*”, me nr. 4 dhe 6 rendor që kanë përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(v) 1 (një) çështje tek tabela nr. 12 tek kategoria e çështjeve “*në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë*”, me nr. 32 rendor e cila ka përfunduar jashtë afatit 2 (dy) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2 date 14.04.2010 ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(vi) 2 (dy) çështje tek tabela nr. 14 tek kategoria e çështjeve “*juridiksion fillestar*”, me nr. 23 dhe nr. 25 rendor të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës në Formularin e Vlerësimit kanë bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me ngarkesën e lartë, fakt i cili rezulton edhe nga analiza e të dhënave statistikore. Gjithashtu bëhet prezent fakti se kohëzgjatja e gjykimeve asnjëherë nuk ka qenë për shkak të gjyqtarës.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues përcaktohet duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor gjykimi. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (12 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (340 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 3.5 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor në Gjykatën e Apelit, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 3.5 %, pavarësisht ngarkesës e cila, referuar të dhënave statistikore rezulton të jetë e lartë, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdesin maksimal për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afateve të shkurtra dhe në 96.5 % të tyre duke respektuar standardin minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të përfunduara në tejkalim të standardit minimal kohor rezulton të jetë vetëm 3.5 %, ndërkohë që ngarkesa e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit rezulton të ketë qenë e lartë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, evidentojnë faktin se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme veprimeve të tilla si studimi paraprak dhe përgatitja për gjykimin e çështjeve, caktimi i datës fillestare të gjykimit dhe shtyrjes së seancave në afate të përshtatshme kohore, duke marrë në konsideratë sensitivitetin e çështjes, kategoritë e veçanta të tyre, ndikimin që ato kanë në çështje të tjera, afatet orientuese në fuqi si dhe praktika gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjes, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pavarësisht volumit të lartë të çështjeve, specifikave të gjykimit në apel në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për zhvillimin e gjykimit brenda afateve të shkurtra, duke treguar shkallë të lartë aftësie.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2019 si periudhë vlerësimi, është 215.9%.

Në Formularin e Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës kanë parashtruar se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie, e cila reflektohet në rendimentin e lartë të përfundimit të çështjeve pavarësisht volumit të lartë, problematikave të krijuara nga ulja e numrit të gjyqtarëve në gjykatë gjatë vitit 2019, për shkak të pezullimit të tyre nga detyra, si dhe angazhimit me kohë të plotë të gjyqtarës në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Lidhur me angazhimin e gjyqtarës si anëtare e KED dhe ndikimin e këtij angazhimi në punën e saj në gjykatë, rezulton se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 58, datë 24.04.2019 dhe nr. 173, datë 11.09.2019 ka vendosur përjashtimin e gjyqtarës Margarita Buhali nga procedurat e shortit për një periudhë 3/mujore, gjithsej 6 muaj në gjithë periudhën e vlerësimit. Kjo ka sjellë si pasojë edhe caktimin e një numri më të ulët çështjesh të reja pasi për gjysmën e periudhës së vlerësimit gjyqtarja ka qenë e përjashtuar nga shorti në gjykatë, çka ndikon drejtpërdrejt në përlllogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore. Pavarësisht këtij fakti që ka ndikuar në të dhënat që konsiderohen për përlllogaritjen e rendimentit, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar gjatë periudhës së vlerësimit një numër të konsiderueshëm çështjesh (në total ka gjykuar 403 çështje si relator dhe 205 çështje si anëtar) duke sjellë efekte të drejtpërdrejta në uljen e back log-ut të çështjeve.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, pavarësisht përjashtimit nga procedura e shortit për gjysmën e kohës së periudhës së vlerësimit për shkak të angazhimit si anëtare e KED-së si dhe referuar analizës së të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka përfunduar si relatore 403 çështje, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 215.9 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, duke qenë se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 215.9 %, pavarësisht se gjyqtarja ka qenë e pezulluar nga procedura e shortit për 1/2 e periudhës së vlerësimit, ky tregues duhet të pikëzohet me 10 pikë, pasi gjyqtarja ka përfunduar një numër të lartë çështjesh (403 çështje si relatore) duke ndikuar drejtpërdrejtë në uljen e back log-ut të çështjeve në gjykatë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës kanë parashtruar se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal në respektimin e afateve procedurale për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe në asnjë rast, në 403 çështje të përfunduara, nuk rezulton që vendimi të

jetë arsyetuar me vonesë, pavarësisht numrit të lartë të vendimeve përfundimtare të marra gjatë periudhës së vlerësimit dhe angazhimit të saj gjatë kesaj periudhe si anëtare e KED-së.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton së gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për arsyetimin e vendimeve në një kohë të shpejtë dhe në çdo rast, brenda afatit procedural, pavarësisht volumit të lartë të çështjeve të përfunduara dhe faktorëve të tjerë që kanë ndikuar në ngarkesën e saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë, duke qenë se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare është më shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.*

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuarat i referohen 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim të cilat janë çështje me palë kundërshtarë. Referuar Raportit Analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për këto 6 çështje, është 3.16 seanca gjyqësore.

Në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ka një rregullim të posaçëm ligjor për përpunimin dhe vënien në lëvizje të çështjeve gjyqësore referuar nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 460 pika 2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78 datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit" në të cilin përcaktohet "*Datë nxjerrje për gjyq*" si veprim që përcakton kohën e fillimit të shqyrtimit të çështjes. Ky moment, përveç çështjeve për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi, kushtëzohet nga kalendari i shqyrtimit të çështjeve, i cili duhet të marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit për çështjet e ardhura mbi bazë apelimi dhe në rastet kur kjo gjykatë shqyrton çështje

të juridiksionit fillestar, planifikimi i seancës së parë gjyqësore ndjek rregullave të përcaktuara në ligjet procedurale, duke mbajtur parasysh objektin e çështjes dhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve.

Në dosjet e përzgjedhura me short për gjyqtaren Margarita Buhali, rezulton se çështjet, pasi janë vënë në lëvizje në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë parasysh edhe kërkesat e palëve për përshpejtim të gjykimit, janë planifikuar për t'u gjykuar brenda një afati të shkurtër kohor dhe në çdo rast duke respektuar afatet procedurale të përcaktuara në nenin 460 të K.Pr.C dhe nenin 426 të K.Pr.P, duke kryer me korrektësi veprimet paraprake të gjykimit sipas parashikimeve të nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 465 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët apo dështim i seancave gjyqësore për shkak të mungesës së njoftimeve, dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Në të gjitha rastet shtyrja e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: - për mosparaqitje të të pandehurit (*pajisur me raport paaftësie të përkohshme*) apo avokatit të zgjedhur të tij (*me kërkesë për shtyrje drejtuar gjykatës*)³¹; - për shkak të përsëritjes së njoftimit të personit të tretë (*shënimi në fletëthirrje afat i shkurtër*)³², - për shkak të kërkesave dhe veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin gjyqësor (*si psh për lejimin dhe marrjen e provës me ekspert është shtyrë seanca për tu njoftuar ekspertja, apo kur mbi disponimin e palës paditëse është saktësuar dhe ndryshuar objekti i padisë dhe për tu komunikuar palëve në mungesë gjykata përsëri ka ndërprerë seancën dhe e ka shtyrë atë për një datë tjetër*)³³, etj. Në dy raste në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues (*shkaqe familjare të anëtareve të tjerë të trupit gjykues*), rezulton që seancat vijuese janë planifikuar në një kohë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Po kështu në rastet kur seanca është shtyrë për mosprezencë të avokatit mbrojtës, gjyqtarja ka marrë masat që të caktojë dhe të thërrasë avokat kryesisht në rastin kur seanca gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të mosprezencës së avokatit të zgjedhur të të pandehurit, me qëllim mosndërprerjen dhe mosshyrjen përsëri të seancës gjyqësore në eventualitetin e mosprezencës së avokatit të të pandehurit në seancën e radhës.³⁴

Në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhet shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces dhe në çdo rast seancat vijuese janë caktuar brenda një afati në maksimum prej 20 - 30 ditësh nga njëra – tjetra.

Vetëm në çështjen me nr. 272 vendimi datë 05.12.2019 rezulton se çështja ka përfunduar jashtë afatit standard minimal kohor nga momenti i nxjerrjes së çështjes për gjykim, pasi rezulton që ka përfunduar në një afat prej 6 muaj dhe 7 ditë, ndërkohë që duhej të përfundonte brenda një afati

³¹Në vendimin nr.102, datë 13.03.2019 e Gjykatës së Apelit Vlorë

³²Në vendimin nr.745 datë 20.11.2019 dhe në vendimin nr. 272 datë 05.12.2019 e Gjykatës së Apelit Vlorë

³³Në vendimin nr. 272 datë 05.12.2019 e Gjykatës së Apelit Vlorë

³⁴Në vendimin nr.102, datë 13.03.2019 e Gjykatës së Apelit Vlorë

prej 6 muajsh sipas vendimit nr. 261/2 të ish KLD-së. Në lidhje me këtë çështje rezulton se ky afat ka kaluar vetëm me 7 ditë dhe për më tepër në këtë rast gjykata e ka shqyrtuar çështjen jo si shkallë e dytë mbi bazë ankimi, por si juridiksion fillestar. Nuk konstatohet që të kenë qenë veprimet e gjyqtarës faktor në zgjatjen e çështjes tej afatit, por kjo ka ndodhur për shkak të mënyrës së procedimit/gjykimit dhe kryerjes së veprimeve procedurale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*si kërkesa për marrjen e provave nga të tretët, kryerja e aktit të ekspertimit teknik, për tu njohur palët me aktin, kërkesa për ndryshimin dhe shtimin e objektit të padisë, etj.*).

KONKLUZIONE:

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 6 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.16 seanca dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Tejkalimi i numrit të seancave që përkon me pikëzimin maksimal me vetëm 0.16 seanca, është një tregues i papërfillshëm dhe nuk ndikon në ndryshimin e shkallë së aftësisë, pasi shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi, është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuar është 3.16 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproduktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se, në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë, duke respektuar kalendarin e gjykimeve, sipas parashikimeve të neneve 460 pika 2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78 datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e palëve për përshpejtimin e gjykimit apo natyrën e çështjeve referuar objektit të saj.

Pas vënies në lëvizje të çështjeve, gjyqtarja, në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore ka caktuar seancën dhe ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve përkatëse për palët.³⁵ Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në procesverbalin audio të seancave (nuk rezultojnë në rastin konkret çështje të shqyrtuara në dhomë këshillimi).

³⁵ Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile dhe neni 426 i K.Pr.Penale

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi, dhe referuar rregullave procedurale përkatëse për gjykimin në shkallë të parë, për aq sa është e mundur, kur gjykata ka gjykuar çështjen si juridiksion fillestar me objekt kundërshtimin e vendimit të ATP-së sipas ligjit 133/2015.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas nenit 461 të K.Pr.Civile, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa³⁶, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë apo juridiksion fillestar*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*).

Përgjithësisht seancat kanë filluar në kohë, me vonesa të vogla (*10 - 20 minuta*). Në ato seanca në të cilat procesi ka filluar me vonesë, nga ana e gjyqtarës është relatuar gjithmonë shkaku, vonesa këto të shkaktuara për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës pasi kanë ardhur si pasojë e vazhdimit tej parashikimit të seancave paraardhëse në të cilat anëtarët e trupit gjykues ose pjesëmarrësit në gjykim kanë qenë të angazhuar, priten për paraqitjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre, etj.

Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.*

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

³⁶ Ne vendimin nr. 272 datë 05.12.2019 e Gjykatës së Apelit Vlorë

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur duke ndjekur rendin kronologjik (sipas datës së aktit). Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, ndjekja e rendit kronologjik për renditjen e akteve, pa i grupuar ato sipas kategorisë, duke qenë se janë zhvilluar përgjithësisht një numër i vogël seancash, nuk krijon vështirësi në aksesimin e dosjes.

Renditja e akteve në dosjet e përzgjedhura me short për vlerësimin është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e zhvillimit të shortit, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet për çdo seance gjyqësore, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të gjykimit si juridiksion fillestar, diskutimet me shkrim të palëve, ekstraktet e procesverbalit të seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës. Në disa nga dosjet e vëzhguara, pas procesverbalit të seancës së fundit gjyqësore në të cilën është shpallur vendimi përfundimtar, administrohet përmbledhja me shkrim e arsytimit të vendimit sipas parashikimeve të nenit 430/1 paragrafi i dytë i K.Pr.P.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore, mendimi i pakicës në rastet kur gjykata ka vlerësuar ndryshe nga shumica) si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e paraqitura për herë të parë në Gjykimin në Apel, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës.

Sa i përket rezultateve të verifikimit të ankesave, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 1793/1 prot., datë 17.08.2020, shkresën nr. 2437/20 prot datë 24.12.2020 dhe shkresën nr. 2437/24 datë 30.12.2020 rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, për gjyqtaren Margarita Buhali janë depozituar tre ankesa të cilat janë verifikuar nga ILD duke konkluduar për arkivimin e tyre me vendimet nr. 1059/4 prot datë 22.12.2020, nr. 1448/5 prot datë 23.12.2020 dhe nr. 1086/3 prot datë 28.12.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për gjyqtaren Margarita Buhali, nuk është dhënë asnjë e tillë.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së tre ankesa me të dhënat si vijon:

(i) Ankues Zoj Meço, ankesë e depozituar pranë KLGJ-së me nr. 2060 prot, datë 08.04.2019, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1059 prot, datë 10.06.2020. Në lidhje me këtë ankesë, me vendimin nr.1059/4 prot datë 22.12.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur: *“Arkivimin e ankesës së z. Zoj Meço me nr. 1059 prot datë 10.06.2020”*.

(ii) Ankuese Liri Zana, ankesë e depozituar pranë KLGJ-së me nr. 5846/1 prot, datë 12.12.2019, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1448 prot, datë 03.07.2020. Në lidhje me këtë ankesë, me vendimin nr. 1448/5 prot datë 23.12.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur: *“Arkivimin e ankesës së znj. Liri Zana me nr. 1448 prot datë 03.07.2020”*.

(iii) Ankuese Liri Zana, ankesë e depozituar pranë KLGJ-së me nr. 2368 prot, datë 24.04.2019, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1086 prot, datë 10.06.2020. Në lidhje me këtë ankesë, me vendimin nr. 1086/3 prot datë 28.12.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur: *“Arkivimin e ankesës së znj. Liri Zana”*.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmëritë e publikut.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 166/24 prot datë 07.07.2020, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cënojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi pezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelleve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, apo përmbajtjes së formularit të integruar të vlerësimit.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për periudhën 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës nga të cilat 6 (gjashtë) janë rrëzuar dhe 1 (një) prej tyre është pranuar.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës, në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues, parashtrojnë se gjyqtarja ka treguar angazhim maksimal për të ruajtur të pacënuar autoritetin dhe integritetin jo vetëm përballë palëve por edhe para kolegëve, në interes të mirëfunksionimit të drejtësisë, duke reflektuar besueshmëri të lartë të palëve në zgjidhjen e drejtë të çështjeve.

KONKLUZIONE:

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paañesi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës (*vetëm një kërkesë është pranuar*), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarës dhe vlerësimin e kryetares lidhur me këtë tregues.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe

mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim korrekt me stafin e gjykatës.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrësit³⁷.

Konkretisht evidentohet se gjyqtarja Magarita Buhali, përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit/pjesëmarrësit, konvertuar në numër ditësh 23 ditë³⁸. Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Gjithashtu referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë gjyqtarja, rezulton se në periudhën 3 - 5 prill 2019, gjyqtarja Margarita Buhali ka qenë në Bosnje në përmbyllje të trajnimit si eksperte e lirisë së shprehjes nga Këshilli i Evropës, aktivitet ky jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës e cila rezulton të jetë aktivitet brenda formimit profesional të saj.³⁹

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, pikëzohet me 20 pikë.

³⁷Shkresa me nr. 534/1 prot, datë 05.08.2020 e Shkollës së Magjistraturës.

³⁸ Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

³⁹ Për trajnimin e sipërcituar, gjyqtarja së bashku me formularin e integruar ka paraqitur edhe ftesën e këtij trajnimi të dërguar në datë 6 Mars 2019 nga Zyra e Këshilli të Evropës në Tiranë dhe gjithashtu ky njoftim ndodhet edhe në dosjen personale të gjyqtarës.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtarja Margarita Buhali përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 4 (katër) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit, me tema të ndryshme në fushën e të drejtës materiale dhe procedurale civile.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren Margarita Buhali duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertit në disa aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë vitit 2019, ka qenë anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ka dhënë kontributin e saj në përpilimin e akteve nënligjore të funksionimit të Këshillit, të procedurave të kualifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve dhe metodologjinë e vlerësimit të tyre, veç vendimeve për kualifikimin e vlerësimit të kandidatëve si për Gjykatën Kushtetuese ashtu edhe për Inspektorë të Lartë të Drejtësisë. Aktet nënligjore të miratuara nga ky Këshill anëtare e së cilës ka qenë në vitin 2019 edhe gjyqtarja M. Buhali janë: Rregullore e brendshme; Vendim nr. 2/2019 «Për procedurat e shortit»; Vendim nr. 4/2019 «Për procedurat e verifikimit të kandidatëve»; Vendim nr.5/2019 «Për procedurat e vlerësimit të renditjes së kandidatëve»; Metodologjia e vlerësimit për kandidatët për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese miratuar me vendimin nr. 51/2019; Metodologjia e vlerësimit për kandidatët për Inspektor të Lartë të Drejtësisë miratuar me vendimin nr. 52/2019. Evidentohet se këto janë akte nënligjore me kontributin e përgjithshëm të anëtarëve të KED-së dhe që ndodhen në faqen zyrtare të KED-së, por gjyqtarja evidenton se ka qenë relatores e vendit vakant në ILD dhe për këtë shkak ka arsyetuar të gjitha vendimet e lejimit apo të ndalimit të kandidimit të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë dhe po kështu ka arsyetuar edhe mendimet ndryshe në lidhje me plotësimin e vendeve vakante të kandidatëve në

Gjykatën Kushtetuese, çka provohet edhe nga informacioni i faqes zyrtare të internetit të KED-së.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren Margarita Buhali, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin “Publikimet ligjore akademike”, gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter

Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja Margarita Buhali të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.